



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-05

**Prokurori kundër Salih Mustafës**

**Vendosi:** Trupi Gjykses I

Gjykatëse Mapi-Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 20 qershor 2022

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim për Mbylljen e Procedurës së Paraqitjes së Provave dhe Çështje në lidhje  
me To**

---

**T'i njoftohet:**

**Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

**Mbrojtjes së të akuzuarit**

Julius von Bone

**Mbrojtëses së Viktimave**

Ani Puz

**TRUPI GJYKUES I** (Trupi Gjykues) lëshon këtë vendim për mbylljen e procedurës së paraqitjes së provave dhe çështjet në lidhje me to.

## I. HSITORIKU PROCEDURAL

1. Më 20 shtator 2021, filloi paraqitja e provave nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”).<sup>1</sup>
2. Më 4 shkurt 2022, ZPS-ja mbylli zyrtarisht paraqitjen e provave të veta.<sup>2</sup>
3. Më 9 shkurt 2022, Trupi Gjykues lëshoi Vendimin e Tretë mbi Zhvillimin e Gjykimit, ku u kërkoi palëve dhe Mbrojtëses së Viktimave të paraqisnin parashtrimet e tyre në përputhje me rregullën 159(6) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”) lidhur me nëse, në rast të shpalljes fajtor të Salih Mustafës (“z. Mustafa” ose “i akuzuari”) për një ose më shumë vepra penale të paraqitura në Aktakuzë, Trupi Gjykues duhet të përcaktojë dënimin e duhur në Aktgjykimin që do të shqiptohet, apo të procedojë në përputhje me rregullat 162 dhe 164 të Rregullores.<sup>3</sup> Mbrojtësja e Viktimave, Mbrojtja e z. Mustafa (“Mbrojtja”) dhe ZPS-ja dorëzuan parashtrimet e tyre përkatësisht më 1, 6 dhe 7 mars 2022.<sup>4</sup>
4. Më 9 mars 2022, Trupi Gjykues miratoi kërkesën e Mbrojtëses së Viktimave për të paraqitur prova dhe që një nga viktimat t’i drejtohej drejtpërdrejt Trupit Gjykues për të shprehur pikëpamjet dhe shqetësimet e veta, përtej provave që i

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-05, Transkripti i seancës, 20 shtator 2021, publik, f. 384, rreshti 18.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-05, F00308, Prokurori i Specializuar, *Njoftim i Prokurorisë për Mbylljen e Paraqitjes së Provave sipas Rregullës 129*, 4 shkurt 2022, publik.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-05, F00318, Trupi Gjykues I, *Vendimi i Tretë mbi Zhvillimin e Gjykimit*, 9 shkurt 2022, publik, para. 15. *Shih gjithashtu*, F00296, Trupi Gjykues I, *Vendimi i Dytë mbi Zhvillimin e Gjykimit*, 21 janar 2022, publik, para. 19-20.

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-05, F00334, Mbrojtësja e Viktimave, *Parashtrime të Mbrojtëses së Viktimave në bazë të Vendimit të Tretë mbi Zhvillimin e Gjykimit* (“Parashtrimet e Mbrojtëses së Viktimave”), 1 mars 2022, konfidenciale; F00335, Mbrojtja, *Parashtrim i Mbrojtjes pas Kërkesës së Trupit Gjykues për Parashtrime në zbatim të Vendimit të Dytë mbi Zhvillimin e Gjykimit* (“Parashtrimet e Mbrojtjes”), 6 mars 2022, publike; F00338, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë në bazë të Vendimit të Dytë dhe të Tretë mbi Zhvillimin e Gjykimit* (“Parashtrimet e ZPS-së”), 7 mars 2022, konfidenciale.

janë paraqitur Trupit Gjykses nga ZPS-ja,<sup>5</sup> dhe: (i) dëgjoi pikëpamjet dhe shqetësimet e viktimës 05/05 më 21 mars 2022;<sup>6</sup> dhe (ii) caktoi Institutin për Kriminalistikë të Holandës (*Nederlands Forensisch Instituut*) të vlerësonte gjendjen psikiatrike dhe të bënte vlerësim mjekësor të dëmit fizik dhe psikologjik dhe lëndimeve të pësuar nga viktimat 08/05, 09/05, dhe 10/05, si rezultat i torturës, trajtimit mizor dhe ndalimit arbitrar që pretendohet se pësuan, dhe të përgatiste aktekspertizën përkatëse.<sup>7</sup> Më 21 mars 2022, Trupi Gjykses vendosi të rishikonte urdhrin e vet të datës 9 mars 2022 lidhur me caktimin e ekspertit dhe caktoi Institutin për Të Drejtat e Njeriut dhe Vlerësim Mjekësor (*Instituut voor Mensenrechten en Medisch Onderzoek* ("iMMO")) të kryente vlerësimin e sipërpërmendur.<sup>8</sup> Më 28 prill 2022, Mbrojtësja e Viktimave njoftoi Trupin Gjykses se nuk ishte e mundur të bëhej ky vlerësim për viktimën 10/05 në të ardhmen e afërt dhe, për rrjedhojë, tërhoqi kërkesën në lidhje me të.<sup>9</sup> Mbrojtësja e Viktimave dorëzoi aktekspertizat e iMMO-së më 24 maj 2022.<sup>10</sup>

5. Më 23 mars 2022, filloi paraqitja e provave nga Mbrojtja.<sup>11</sup>

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-05, Transkripti i seancës, 9 mars 2022, publik, f. 2519, rreshti 18 deri në f. 2521, rreshti 24; shih gjithashtu, F00297, Mbrojtësja e Viktimave, *Kërkesë e Mbrojtëses së Viktimave në bazë të Vendimit të Dytë mbi Zhvillimin e Gjykimit të datës 21 janar 2022, 24 janar 2022*, konfidencial; para. 30.

<sup>6</sup> KSC-BC-2020-05, Transkripti i seancës, 21 mars 2022, konfidencial, f. 2531, rreshti 15 deri në f. 2554, rreshti 15.

<sup>7</sup> KSC-BC-2020-05, Transkripti i seancës, 9 mars 2022, publik, f. 2533, rreshti 12 deri në f. 2534, rreshti 4.

<sup>8</sup> KSC-BC-2020-05, Transkripti i seancës, 21 mars 2022, konfidencial, f. 2533, rreshti 11 deri në f. 2534, rreshti 4.

<sup>9</sup> KSC-BC-2020-05, F00398, Mbrojtësja e Viktimave, *Raporti i Dytë i Mbrojtëses së Viktimave në bazë të Urdhrit Gojor të 21 marsit 2022 dhe Përgjigje ndaj Urdhrit Gojor të 11 prillit 2022*, 28 prill 2022, konfidencial, para. 7-9, 11(b). Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 21 maj 2022, F00398/RED. Urdhri përkatës për vlerësim mjekësor të viktimës 10/05 u tërhoq, F00403/RED, Trupi Gjykses I, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Zgjatjen e Afateve për Dorëzimin e Raporteve Mjekësore dhe Urdhër për Dorëzimin e Mendimit të Mëtejshëm*, 6 maj 2022, publik, para. 10.

<sup>10</sup> KSC-BC-2020-05, F00417, Mbrojtësja e Viktimave, *Parashtrim i Aktekspertizave Mjekësore lidhur me Viktimat 08/05 dhe 09/05 prej Mbrojtëses së Viktimave*, 24 maj 2022, publik, me shtojcat 1 dhe 2, rreptësisht konfidenciale.

<sup>11</sup> KSC-BC-2020-05, Transkripti i seancës, 23 mars 2022, publik, f. 2608, rreshtat 23-24.

6. Më 26 maj 2022, Mbrojtja mbylli zyrtarisht paraqitjen e provave të veta.<sup>12</sup>
7. Më 1 qershor 2022, pasi miratoi lejen për këtë qëllim,<sup>13</sup> Trupi Gjykses dëgjoi dëshminë e një dëshmitari të ZPS-së të paraqitur si kundërprovë<sup>14</sup> dhe mori një kërkesë nga ZPS-ja për pranimin e kundërprovave dokumentare.<sup>15</sup>
8. Më 3 qershor 2022, Trupi Gjykses lëshoi Vendimin në Bazë të Rregullave 132 dhe 149 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës në lidhje me Prova të Kërkuara nga Trupi Gjykses, në të cilin vendosi të pranonte si prova aktekspertizat e iMMO-së, në pajtim me rregullën 132 të Rregullores.<sup>16</sup>
9. Më 9 qershor 2022, Mbrojtja dorëzoi kërkesë për paraqitjen e kundërprovave të veta.<sup>17</sup>
10. Më 20 qershor 2022, Trupi Gjykses lëshoi Vendimin mbi Materialet e Përdorura me Dëshmitarët WDSM 600 deri 1100, 1300 deri 1700 dhe [Redaktuar] gjatë Dëshmive të tyre në Sallë të Gjyqit, mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Kundërprovave Dokumentare dhe Kërkesën e Mbrojtjes për Paraqitjen e Kundërprovave të Mbrojtjes,<sup>18</sup> në të cilin miratoi kërkesën e ZPS-së për pranimin e

---

<sup>12</sup> KSC-BC-2020-05, F00421, Mbrojtja, *Njoftim i Mbrojtjes sipas Rregullës 131 për Mbylljen e Paraqitjes së Provave të Mbrojtjes*, 26 maj 2022, publik.

<sup>13</sup> KSC-BC-2020-05, F00424, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Paraqitje të Kundërprovave*, 27 maj 2022, konfidencial, para. 15. Versioni i redaktuar publik u nxor në të njëjtën ditë, F00424/RED.

<sup>14</sup> KSC-BC-2020-05, Transkripti i seancës, 1 qershor 2022, konfidencial.

<sup>15</sup> KSC-BC-2020-05, F00426, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Pranimin e Kundërprovave Dokumentare*, 1 qershor 2022, publike, me shtojcën 1, konfidenciale.

<sup>16</sup> KSC-BC-2020-05, F00430, Trupi Gjykses I, *Vendim në Bazë të Rregullave 132 dhe 149 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës në lidhje me Prova të Kërkuara nga Trupi Gjykses*, 3 qershor 2022, konfidencial, para. 13. Versioni i redaktuar publik u nxor në të njëjtën ditë, F00430/RED.

<sup>17</sup> KSC-BC-2020-05, F00434, Mbrojtja, *Kërkesë e Mbrojtjes për Paraqitje të Kundërprovave të Mbrojtjes dhe Çështje në lidhje me To, në vijim të Urdhrit të Trupit Gjykses në përputhje me Vendimin F00430*, 9 qershor 2022, konfidenciale, me shtojcën 1, konfidenciale.

<sup>18</sup> KSC-BC-2020-05, F00436/RED, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Materialet e Përdorura me Dëshmitarët WDSM 600 deri në 1100, 1300 deri në 1700 dhe [Redaktuar] gjatë Dëshmisë së Tyre në Sallë të Gjyqit, mbi*

kundërprovave dokumentare dhe e vlerësoi të tejkalar kërkesën e Mbrojtjes për paraqitjen e kundërprovave të veta.

## II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

11. Trupi Gjykses mbështetet në nenin 40(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe rregullat 9(5)(a), 134, 135, 159(6), dhe 163 të Rregullores.

## III. ANALIZË

### A. MBYLLJA E PROCEDURËS SË PARAQITJES SË PROVAVE

12. Trupi Gjykses vëren se janë përfunduar të gjithë hapat e detyrueshëm të përcaktuar në kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara sa i përket paraqitjes së provave në këtë çështje gjyqësore në lidhje me përcaktimin e fajësisë apo pafajësisë së të akuzuarit. Për rrjedhojë, dhe në pajtim me rregullën 134(a) të Rregullores, Trupi Gjykses e gjykon të përshtatshme të mbyllë procedurën e paraqitjes së provave në këtë çështje gjyqësore.

### B. PROCEDURA E PËRCAKTIMIT TË DËNIMIT

13. Trupi Gjykses rikujton se rregulla 159(6) e Rregullores përcakton se, në qoftë i akuzuari shpallet fajtor për një ose më shumë vepra penale, trupi gjykses përcakton dënimin e duhur për të akuzuarin që shqiptohet në vendimin e gjykimit, përveçse pasi të ketë dëgjuar palët, trupi gjykses vendos të procedojë në përputhje me rregullën 162 dhe rregullën 164.

---

*Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Kundërprovave Dokumentare dhe Kërkesën e Mbrojtjes për Paraqitje të Kundërprovave të Mbrojtjes, 20 qershor 2022, publik.*

14. Mbrojtja parashtron se Trupi Gjykues duhet të procedojë në përputhje me rregullat 162 dhe 164 të Rregullores.<sup>19</sup> Mbrojtja më tej bën me dije se do të ishte në pozitë më të mirë të trajtonte dënimin pas shqiptimit të vendimit në lidhje me fajësisë,<sup>20</sup> pasi, për mendimin e Mbrojtjes, është e pamundur të parashihet në këtë fazë se për cilat akuza mund të shpallet fajtor i akuzuari.<sup>21</sup> ZPS-ja parashtron se, në qoftë se i akuzuari shpallet fajtor, Trupi Gjykues duhet të përcaktojë dënimin e duhur në Aktgjykimin që do të shqiptohet, në pajtim me rregullën 159(6) të Rregullores.<sup>22</sup>

15. Pasi ka marrë parashtrimet e palëve dhe të Mbrojtëses së Viktimave, Trupi Gjykues thekson se rregulla 159(6) qartësisht përmban prezumimin se dënimi që do t'i jepet të akuzuarit duhet të shqiptohet në të njëjtën kohë me Aktgjykimin, në rast se i akuzuari shpallet fajtor për një ose më shumë vepra penale. Për këtë arsye, në ushtrimin e zellshëm të përgjegjësive të tyre, palët dhe Mbrojtësja e Viktimave duhet të kenë përgatitur dhe paraqitur në gjykim të gjitha provat që i kanë vlerësuar të rëndësishme për përcaktimin e dënimit.<sup>23</sup> Trupi Gjykues nuk sheh asnjë arsye që në këtë çështje të procedojë në pajtim me rregullat 162 dhe 164 të Rregullores. Në këtë kontekst, argumenti i Mbrojtjes se do të ishte në pozitë më të mirë të trajtonte dënimin pas shqiptimit të vendimit në lidhje me fajësinë, nuk është bindës dhe është në kundërshtim me parimin e efikasitetit të procedurës penale. Nëse në fund i akuzuari do të shpallet fajtor për një ose më shumë vepra penale ose jo, kjo nuk e pengon Mbrojtjen, pasi është njohur tërësisht me akuzat, që në këtë fazë të bëjë parashtrimet përkatëse dhe të paraqesë prova, nëse dëshiron, mes të cilave edhe lidhur me rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Vendimi i pafajësisë për një ose më shumë akuza, apo

---

<sup>19</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 12-18.

<sup>20</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 12-18.

<sup>21</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 14.

<sup>22</sup> Parashtrimet e Mbrojtëses së Viktimave, para. 28.

<sup>23</sup> *Shih*, KSC-BC-2020-07, F00553, Trupi Gjykues II, *Vendim për Mbylljen e Procedurës së Paraqitjes së Proovave dhe për Parashtrime sipas Rregullave 134(b), (d) dhe 159(6) të Rregullores*, 3 shkurt 2022, publik, para. 16-18. *Shih gjithashtu*, F00572, Trupi Gjykues II, *Vendim mbi Kërkesën e ZPS-së për Nxjerrjen e Proovave Shtesë në lidhje me Përcaktimin e Dënimit*, 10 mars 2022, publik, para. 11-12.

përcaktimi përfundimtar i formës së përgjegjësive penale në rast të një vendimi fajësie, do të shqyrtohen me kujdes kur të peshohen argumentet dhe provat përkatëse të palëve dhe Mbrojtëses së Viktimave dhe kur të vendoset për dënimin.

16. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses urdhëron palët dhe Mbrojtësen e Viktimave të paraqesin prova lidhur me përcaktimin e dënimit dhe t'i nxjerrin ato në sistemin *Legal Workflow*, si dhe të dorëzojnë kërkesa për paraqitjen e këtyre provave, brenda të premtës, 1 korrik 2022. Gjithashtu, për të garantuar proces të shpejtë, Trupi Gjykses vendos, në pajtim me rregullën 9(5)(a) të Rregullores, të shkurtojë afatet për dorëzimin e përgjigjeve dhe urdhëron palët dhe Mbrojtësen e Viktimave të dorëzojnë përgjigjet ndaj kërkesave të tilla brenda të mërkurës, 6 korrik 2022.

17. Veç kësaj, Trupi Gjykses urdhëron palët dhe Mbrojtësen e Viktimave që në dosjet gjyqësore përfundimtare të tyre, në deklaratën mbi pasojat e veprave penale të pretenduara mbi viktimat pjesëmarrëse në proces ("Deklarata mbi Pasojat"), dhe/ose në deklaratat e tyre përmbyllëse, të përfshijnë - nëse dëshirojnë - parashtrime që trajtojnë aspektet vijuese: (i) faktorët rëndues dhe lehtësues që janë relevantë për përcaktimin e dënimit, përfshirë peshën e veprave penale të pretenduara, llojin dhe shkallën e përfshirjes së të akuzuarit në veprat penale, dhe rrethanat individuale të të akuzuarit, siç përcaktohet në veçanti në nenin 44(5) të Ligjit dhe rregullën 163(1) të Rregullores;<sup>24</sup> (iii) çdo dënim që propozohet të përcaktohet në pajtim me rregullën 163(4) të Rregullores, dhe (iv) çdo informacion tjetër relevant që mund ta ndihmojë Trupin Gjykses në përcaktimin e dënimit të duhur.

### C. DOSJET GJYQËSORE PËRFUNDIMTARE

18. Pasi deklaroi mbylljen e procedurës së paraqitjes së provave në këtë vendim, Trupi Gjykses, në përputhje me rregullën 134(b) dhe (c) të Rregullores, fton ZPS-në,

---

<sup>24</sup> *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-07, F00611/RED, Trupi Gjykses II, *Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit*, 18 maj 2022, publik, para. 943-950, me shtojcat 1-3, publike.



Mbrojtjen dhe Mbrojtësen e Viktimave të dorëzojnë dosjet gjyqësore përfundimtare dhe Deklaratën mbi Pasojat brenda të enjtes, 21 korrik 2022.

19. Trupi Gjykses u kujton palëve dhe Mbrojtëses së Viktimave se parashtrimet në dosjet gjyqësore përfundimtare dhe në Deklaratën mbi Pasojat duhet të jenë të fokusuar dhe koncize. Trupi Gjykses pret nga palët dhe Mbrojtësja e Viktimave të përqendrohen në fakte, aspekte dhe rrethana që janë relevante për argumentet dhe provat tyre.

20. Mbrojtja dhe Mbrojtësja e Viktimave mund të përfshijnë gjithashtu edhe parashtrime lidhur me procesin e zhdëmtimit, të cilat do të merren parasysh në rast se Trupi Gjykses e shpall të akuzuarin fajtor për një ose më shumë vepra penale, por nuk duhet të përsërisin argumentet e përfshira në parashtrime të mëhershme dhe thjesht mund t'iu referohen atyre.

21. Palët dhe Mbrojtësja e Viktimave po ashtu duhet të shmangin citimet e gjata të historikut procedural, përmbledhjet e dëshmimeve dhe provave të dëguara nga Trupi Gjykses, dhe/ose citimet fjalë për fjalë të legjislacionit apo precedentëve. Gjithashtu duhet të shmangen deklarata politike dhe komente fyese për palët, pjesëmarrësit, dëshmitarët dhe viktimat. Palët dhe Mbrojtësja e Viktimave duhet t'u referohen provave që ka në dispozicion Trupi Gjykses për kuvendimet lidhur me Aktgjykimin duke përdorur numrin e regjistrimit të provës ("ERN").

#### D. DEKLARATAT PËRMBYLLËSE

22. Në pajtim me rregullën 134(d) të Rregullores, Trupi Gjykses cakton një seancë për deklaratat përmbyllëse që mbahet brenda njëzet e një (21) ditësh pas dorëzimit të dosjeve dhe deklaratës ose deklaratave të përmendura në rregullën 134(b) dhe (c) të Rregullores. Rendi i deklaratave përmbyllëse përcaktohet në rregullën 135(1) të Rregullores. Duke pasur parasysh afrimin e periudhës së pushimeve verore të



gjykatës,<sup>25</sup> Trupi Gjykses e çmon të përshtatshme, në bazë të rregullës 9(5)(a) të Rregullores, të zgjasë afatet për seancën e deklaratave përmbyllëse dhe vendos të mbajë këtë seancë të martën më 13 shtator 2022, të mërkurën, 14 shtator 2022, dhe të enjten, 15 shtator 2022, me të premten, 16 shtator 2022, si ditë rezervë, me kohëzgjatje 5 orë e 30 minuta gjithsej për ditë seance.<sup>26</sup> Për të përgatitur një kalendar efikas dhe të drejtë për deklaratat përmbyllëse, Trupi Gjykses urdhëron palët dhe Mbrojtësen e Viktimave që deri të martën, 23 gusht 2022, të dorëzojnë parashtrime ku të japin vlerësimet e tyre për kohën që kërkojnë për të bërë deklaratat përmbyllëse, përfshirë edhe kohën e nevojshme për të trajtuar aspektet në lidhje me fajësinë ose pafajësisë e të akuzuarit, përcaktimin e dënimit dhe zhdëmtimet (aspekti i fundit është vetëm për Mbrojtjen dhe Mbrojtësen e Viktimave), duke mbajtur parasysh se qëllimi i deklaratave përmbyllëse nuk është përsëritja e argumenteve që përmbajnë dosjet gjyqësore përfundimtare apo Deklarata mbi Pasojat. Ftohet Mbrojtja që deri më 23 gusht 2022, të njoftojë nëse z. Mustafa do të ushtrojë të drejtën e tij për të marrë fjalën i fundit, në pajtim me rregullën 135(4), fjalia e tretë, të Rregullores.

23. Që parashtrimet nga palët dhe Mbrojtësja e Viktimave të jenë sa më të qarta, Trupi Gjykses rikujton se mund të bëjë pyetje në çdo moment gjatë seancës së deklaratave përmbyllëse.<sup>27</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykses u kujton palëve dhe Mbrojtëses së Viktimave se, në bazë të rregullës 135(2) të Rregullores, në deklaratat përmbyllëse mund të përmenden dëshmitë e pranuar që janë në dispozicion të Trupit Gjykses për kuvendimet lidhur me Aktgjykimin dhe besueshmëria e tyre, besueshmëria e dëshmitarëve, dokumentacioni i procesit dhe dispozitat ligjore përkatëse. Në përputhje me paragrafët 17 dhe 20 të këtij vendimi, në deklaratat përmbyllëse mund të trajtohen edhe përcaktimi i dënimit dhe zhdëmtimi. Mund të përdoret edhe material ilustrues dhe përmbledhje të dëshmimeve, në qoftë se janë të bazuara në provat

---

<sup>25</sup> KSCPR-2021/F00002, Kryetarja, *Periudhat e Pushimit të Gjykatës për Vitin 2022*, 11 nëntor 2021, publike.

<sup>26</sup> Katër seanca për ditë, siç vijon: 09:30-11:00; 11:30-13:00; 14:30-16:00; 16:30-17:30.

<sup>27</sup> Rregulla 135(3) e Rregullores.

e pranuara. Palët dhe Mbrojtësja e Viktimave duhet t'u referohen provave duke përdorur numrat e regjistrimit të provës, përkatësisht ERN-të e tyre. Gjithashtu, në rast se palët dhe Mbrojtësja e Viktimave dëshirojnë të përdorin materiale vizuale apo mjete të tjera ndihmëse gjatë seancës së deklaratave përmbyllëse, këto materiale duhet t'i komunikojnë përmes Njesisë për Administrimin e Gjykatës, të paktën pesë ditë përpara fillimit të seancës së deklaratave përmbyllëse dhe jo më vonë se të mërkurën, 7 shtator 2022.

24. Së fundi, Trupi Gjykues thekson se, në deklaratat e tyre përmbyllëse, palët dhe Mbrojtësja e Viktimave nuk duhet të përsërisin argumentet e paraqitura në dosjet gjyqësore përfundimtare dhe Deklaratën mbi Pasojat, por duhet të përqendrohen në aspekte që nuk janë trajtuar ende ose t'u përgjigjen argumenteve të bëra nga pala tjetër apo Mbrojtësja e Viktimave. Duhet të shmangen deklarata politike dhe komente fyese lidhur me palët, pjesëmarrësit, dëshmitarët dhe viktimat.

## IV. VENDIM

25. Për arsyet e cekura më lart, Trupi Gjykues:

- a. **VENDOS** të mbyllë procedurën e paraqitjes së provave në çështjen **Prokurori kundër Salih Mustafës (KSC-BC-2020-05)**;
- b. **URDHËRON** palët dhe Mbrojtësen e Viktimave që brenda **të premtes, 1 korrik 2022**, të parashtrojnë kërkesat e tyre për paraqitjen e provave lidhur me përcaktimin e dënimit, me përgjigjet, nëse do të ketë, brenda **të mërkurës, 6 korrik 2022**, sikurse specifikohet në paragrafin 16 më lart ;
- c. **URDHËRON** palët dhe Mbrojtësen e Viktimave që brenda **të enjtes, 21 korrik 2022**, të dorëzojnë dosjet gjyqësore përfundimtare dhe Deklaratën mbi Pasojat, sikurse specifikohet më në hollësi në paragrafët 19-21 më lart;
- d. **URDHËRON** palët dhe Mbrojtësen e Viktimave që brenda **të martës, 23 gusht 2022**, të dorëzojnë parashtrime, në përputhje me paragrafët 22-24 më lart, lidhur me kohën që vlerësojnë se do t'u nevojitet për deklaratat përmbyllëse të tyre;
- e. **PLANIFIKON** seancën e deklaratave përmbyllëse për të martën, **13 shtator 2022, të mërkurën, 14 shtator 2022 dhe të enjten, 15 shtator 2022, me të premten, 16 shtator 2022**, si ditë rezervë, sikurse specifikohet në paragrafin 22 më lart, dhe
- f. **URDHËRON** palët dhe Mbrojtësen e Viktimave t'u përmbahen udhëzimeve të përcaktuara në paragrafët 22-24 më lart.

/nënshkrimi/

---

**Gjykatëse Mapi Feld-Folia**  
**Kryegjykatëse**

/nënshkrimi/

---

**Gjykatës Zhilber Biti**

/nënshkrimi/

---

**Gjykatës Roland Dekers**

E hënë, 20 qershor 2022

Në Hagë, Holandë